

DITARI MUJOR PRILL 2024



REKORD VIZITORËSH NË MUZETË KOMBËTARË

Rekord i vizitorëve në muzetë kombëtarë!

54,721 turistë kanë vizituar muzetë kombëtarë në periudhën Janar - Mars 2024, **122%** më shumë krahasuar me vitin 2023! Hyrja në të gjithë muzetë është falas në të dielën e fundit të muajit.

NËNSHKRUHEN NË PARIS DY MARRËVESHJE PRIORITARE ME QEVERINË FRANCEZE



Ministri Gonxhja në Pallatin Elysee, në emër të Qeverisë Shqiptare, nënshkruan dy marrëveshje prioritare me Qeverinë Franceze, që do t'i hapin rrugën zhvillimit të projekteve strategjike në sektorë të ndryshëm, thelbësorë për përparimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Marrëveshja e parë, një Marrëveshje Ndërqeveritare e nivelit më të lartë, që për herë të parë hedh bazat për bashkëpunimin në projekte strategjike mbi turizmin, menaxhimin e ujit, mjedisin e mbetjet, inovacionin, dixhitalizimin, energjinë, infrastrukturën e transportin, arsimin, administratën publike, shëndetësinë dhe bujqësinë, nisma që do të realizohen në nivel dypalësh, si edhe nga sipërmarrjet më të mirënjohura franceze, falë edhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të shtetit francez.

Marrëveshja e dytë, i hap rrugën financimit të programit transformues të titulluar "Zhvillim i Gjelbër dhe i Qëndrueshëm". Në kuadër të kësaj nisme, Shqipëria do të mbështetet në vlerën 120 milionë euro nga Agjencia Franceze e Zhvillimit, fond që do të shërbejë si katalizator për implementimin e projekteve dhe reformës transformuese të ndërmarrë nga Ministria e Turzimit dhe Mjedisit.

FIRMOSET MARRËVESHJA PËR ZONËN E LIRË TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK TEDA

Së bashku me Kryebashkiakun e Tiranës, u firmos marrëveshja e parë e liçensimit nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për Zhvillues Publik - Bashkia Tiranë. Moment historik për nga risia dhe rëndësia si investim. Me një vlerë investimi prej 103 milionë Euro, TEDA Tirana do të gjenerojë 5-7 mijë vende pune cilësore që do të transformojnë peisazhin ekonomik të rajonit, duke rritur lëvizjen e shpejtë të mallrave dhe kapitalit me synim nxitjen e industrisë që përmbush standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, eficiencën në përdorimin e energjisë dhe produktivitetin e lartë.



SHPALLEN FITUESIT E THIRRJES SË TRETË, NË KUADRIN E FONDIT RAJONAL TË SFIDAVE

Fondi Rajonal i Sfidave (Regional Challenge Fund – RCF), një instrument financimi i krijuar për të rritur punësueshmërinë, me fokus tek të rinjtë si dhe për të forcuar konkurrueshmërinë e sipërmarrjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në thirrjen e tretë janë shpallur 10 konsorciume fituese, nga të cilat 7 Institucione publike të arsimit dhe formimit profesional të cilat përfitojnë fondin 5,390,834 Euro.

Nëpërmjet këtyre projekteve dhe financimeve, shkollat profesionale dhe qendrat publike të formimit profesional plotësojnë një pjesë të nevojave të tyre që janë të lidhura me infrastrukturën, pajisjet/laboratorët apo trajnimet e stafeve drejtuese dhe mësimdhënëse, duke hapur rrugën për zhvillim të arsimit dhe bashkëpunimit me sektorin privat e duke rritur mundësitë e punësimit sipas standardeve më të larta të kualifikimit.



Panairi kombëtar i punës dhe aftësive

U zhvillua Panairi Kombëtar i Punës dhe Aftësive 2024 në bashkëpunim me AKPA dhe Dhomën Kombëtare të Tregtisë dhe Industrisë, me pjesëmarrjen e shumë bizneseve, universiteteve dhe punëkërkesve.

Morën pjesë mbi 500 biznese që ofruan mbi 2000 vende të lira pune. Gjithashtu mbi 25 Universitete të cilat prezantuan ofertën e tyre arsimore.

SHQIPËRIA NË BIENALEN E VENEZIAS ME “LOVE AS A GLASS OF WATER”

U çel në edicionin e 60-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit - La Biennale di Venezia, pavijoni i Shqipërisë i përfaqësuar nga artistja shqiptare Iva Lulashi, me projektin “Love as a Glass of Water”, nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

“Love as a Glass of Water”, sillet rreth subjekteve universale të afta për të kapërcyer dallimet dhe kufijtë, jo vetëm ato gjeografike. Pavijoni Shqiptar është kuruar nga Antonio Grulli, i cili ka qenë shoqëruar i ekspozitës, duke krijuar për shikuesin mundësinë e eksplorimit të veprave si nga ambienti i jetesës së vetë artistes me gjithë elementët që rezonojnë në veprën e Lulashit.





Ekspozita në Muzeun e Fotografisë Marubi

Felice Beato dhe Adolfo Farsari: Dy Italianë në Lindjen e Largët kuruar nga Fondacioni Alinari për Fotografinë, konsulente shkencore Rossella Menegazzo. Muzeu Kombëtar i Fotografisë "MARUBI" Shkodër ekspozitës me pamje të magjishme të tempujve, ritualeve, traditave e peizazheve të Japonisë, vende të skalitura në kohë e në histori, të paraqitura në imazhe që përpiqen të frenojnë forcën e pashmangshme e shndërruese të modernitetit.

PRESIDENCA E KËSHILLIT EVROPIAN DHE PARLAMENTI EVROPIAN KANË MIRATUAR MARRËVESHJEN E PËRKOHSHME, QË I JEP DRITËN JESHILE PLANIT TË RRRITJES PËR BALLKANIN PERËNDIMOR!



Marrëveshja parashikon një investim prej 6 miliardë eurosh nga BE, që do të nxisë rritjen ekonomike në të gjithë rajonin, për të kapërcyer hendekun në standardet e jetesës midis Ballkanit dhe BE-së. Premtimi i BE-së për të përshpejtuar integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në Tregun Unik dhe mbështetja për forcimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, hap rrugën për perspektivën e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe forcës punëtore, nxitjes së tregut të përbashkët digjital, liberalizimit të transportit dhe integrimin në zinxhirët e furnizimit industrial.

NIS SHUMË SHPEJT REHABILITIMI I GODINAVE TË ISH BURGUT TË SPAÇIT!

MEKI do të nisë shumë shpejt me rehabilitimin e ambienteve të godinave të ish-Burgut të Spaçit, duke mos lejuar degradimin e godinave, e duke e kthyer atë në një vend kujtese. Gjithashtu, është menduar dhe realizimi i një muzeu pranë godinave të ish-burgut, ku do të ekspozohen artefaktet e trashëguara për të përkujtuar, për të mos harruar! Në ekspozitën "E Kaluara e Tashme" e cila u ngrit për të qëndruar përgjithmonë në Spaç të

Mirditës, 49 portretet e ish të burgosurve politik që janë ende në jetë, bashkë me rrëfimet e tyre prekëse por edhe të guximshme, janë tashmë të hapura për publikun e kushdo mund të shohë trupëzimin e 49 portreteve në një skulpturë të vetme e cila kthehet në një monument të kujtesës kolektive, pikëtakim dhe pikënisje e procesit zhvillimor shoqëror.



DËGJESË PUBLIKE: PLANI I MENAXHIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK TË BYLISIT DHE QYTETIT ANTIK TË KLOSIT

Organizuar në kuadër të përgatitjes dhe hartimit të Planit të Menaxhimit të Parkut Arkeologjik të Bylisit dhe qytetit antik të Klosit, financuar nga projekti IPA “BE për Zhvillimin Ekonomik drejtuar nga turizmi, zhvillimi ekonomik dhe vendor, me fokus mbi Trashëgiminë Kulturore”, i cili zbatohet nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS), Tiranë, nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ky plan synon përmirësimin e aksesueshmërisë, me qëllim promovimin e rëndësisë kulturore të sitit, përmes një rrëfimi historik tërheqës dhe emocional, nxitjes së turizmit kulturor dhe inkurajimit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.



SHQIPËRIA VLERËSOHET ME ÇMIM PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ELEKTRONIKE NË FORUMIN RAJONAL PËR MBROJTJEN SHOQËRORE PËR EUROPËN, NË PORTO TË PORTUGALISË



Programi për mbrojtjen e veçantë, për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të mitur, për të cilat shteti mbulon kontributet e sigurimeve shoqërore u vlerësua me çmimin "Certifikatë e Meritës me Përmendje të Veçantë" nga Komisioni Teknik i ISSA-s dhe Juria e pavarur ndërkombëtare e Konkursit “ISSA Good Practice Award Europe 2024”.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore që po merr pjesë në këtë aktivitet u vlerësua gjithashtu edhe me "Certifikata Merite" për 3 praktika:

- Digjitalizim i arkivës së sigurimeve shoqërore;
- Përmirësimi i përfitimeve të sigurimeve shoqërore nëpërmjet raporteve elektronike mjekësore (e-Raporte);
- si edhe për të gjitha shërbimet e tjera të ofruara online.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR NGRITJEN E SHKOLLËS SË EKSELENCËS NË HOTELERI-TURIZËM

Falë diskutimeve me Shkollën e Hotelerisë së Lozanës së bashku me Ambasadën e Zvicrës në Shqipëri, u nënshkrua marrëveshja për zbatimin e një projekti i cili ka në fokus ngritjen e shkollës së ekselencës në drejtimin e Hoteleri - Turizmit në Tiranë.


Një proces i cili do të shtrihet në disa hapa duke nisur me formulimin dhe përshatjen e programeve të studimit, e që do të plotësohet edhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.



ECIN ME RITËM PUNIMET NË MOZAIKUN E TIRANËS

Po ecin me ritëm punimet në kantierin e Mozaikut të Tiranës, një qendër ku do të ekspozohen për publikun mozaikët e mbyllur të periudhës së antikitetit dhe atyre të antikitetit të vonë që gjenden në shtet tona më të rëndësishme si Apollonia, Butrinti, Bylis, Durrësi, Elbasani, dhe shumë të tjera.

Kjo iniciativë e shkëlqyer do të lejojë qytetarët të shijojnë pasurinë kulturore të vendit nëpërmjet teknologjive moderne, duke e bërë atë të arritshme për një gamë të gjerë publiku. Marrë parasysh se mozaikët hapen rrallë për publikun duke qenë se janë të rrezikuar nga kushtet atmosferike, Mozaiku i Tiranës do të ofrojë një grafik të përcaktuar vjetor për publikun dhe turistët e shumtë.



PARKU TEKNOLOGJIK “DURANA TECH PARK”

Në një kohë rekord, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, finalizoi një proces që kërkonte guxim e që pritej prej vitesh, duke plotësuar dokumentacionin dhe propozuar për Këshillin e Ministrave vendimin historik për të bërë realitet parkun e parë teknologjik dhe shkencor shqiptar.

DURANA Tech Park ofron avantazhe nxitëse, financiare dhe administrative, për kompanitë e IT dhe nomadët digjitalë. Kjo qendër, që do të vijojë të zgjerohet në sipërfaqe, do të revolucionarizojë peisazhin e skenën teknologjike, duke ofruar një sërë mundësish nga dizajni i softuerit deri te hulumtimi i robotikës.



FASONERIA NË SHQIPËRI: GARANCI SOVRANE PËR INDUSTRIJË, NJË RISI E RËNDËSISHME NË MBËSHTETJEN FINANCIARE



Miratuam garancinë sovranë për sektorin e fasonerisë me një vlerë prej 4 miliardë lekësh! Kjo paketë ofron një mbulim me garanci deri në masën 70% të marrjes së kredive për sektorin e industrisë përpunuese.

Kjo do të mundësojë financim për investime dhe kapital qarkullues, duke lejuar deri në 30% të financimit për blerjen e lëndës së parë. Bizneset e sektorit të industrisë përpunuese do të kenë mundësi të aplikojnë për kredi me kushte lehtësuese.

Marrëveshja gjithashtu kufizon normën e interesit për kreditat dhe standardizon tarifën nga bankat, duke sjellë stabilitet dhe siguri për bizneset.

ILIR IKONOMI FITON ÇMIMIN "LUMO SKËNDO" 2023 ME VEPRËN E TIJ "FAN NOLI -APOSTULLI"

Çmimi "Lumo Skëndo", themeluar nga Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, promovon veprat dhe autorët që pasurojnë botën letrare dhe ndërgjegjen kombëtare me kontributin e tyre në publicistikë dhe eseistikë. Ky vit ishte i veçantë për numrin dhe cilësinë e veprave konkurruese, që reflektojnë thellësinë artistike dhe integritetin shkencor.

Misioni i vlerësimit dhe stimulimit të botimeve me vlera të spikatura në këto fusha përmes evokimit të personalitetit të kulturës dhe të mendimit shqiptar, është mision që edhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit e gjen të integruar në të gjitha segmentet e saj të politikave publike, por edhe mbështetjeve që jep pikërisht për të tilla nisma të lavdërueshme.



KONKURSI NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIN EXPO ALBANIA

EXPO Albania do ta shndërrojë Tiranën në një destinacion lider në rajon për organizimin e evenimenteve të industrisë, panairove tregtare dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme, si rajonale ashtu edhe globale, me fokus kryesisht të rinjtë, duke i dhënë shtysë ekonomisë, njohurive dhe kapaciteteve novatore të qytetit si dhe duke konsoliduar më tej rolin e tij në rajon si një destinacion dinamik.

Skuadra e mirënjohur amerikane e Steven Hall u përzgjedh si fituese e Konkursit Ndërkombëtar për Projektin e EXPO Albania, në konkurim me katër kompani të tjera prestigjioze arkitekturore me një eksperiencë shumëvjeçare mbarëbotërore.



SHPALLEN FITUESIT E SKEMËS SË GRANTEVE SMART&GREEN FUTURE

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit shpall listën e fituesve të skemës së granteve Smart&Green Future.

Urime për 75 sipërmarrësit dhe aspirantët për sipërmarrje që do të përfitojnë nga kjo iniciativë për të përmirësuar bizneset e tyre duke integruar elemente të gjelbra dhe dixhitale.

Lista e fituesve gjendet në www.meki.gov.al



ZHVILLOHET RAUNDI I PARË I NEGOCIATAVE ME POLONINË PËR MARRËVESHJEN KUADËR NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE



Në datat 22-24 prill 2024 u zhvillua në Varshavë, në një atmosferë shumë bashkëpunuese, raundi i parë i negociatave për finalizimin e Marrëveshjes Kuadër në fushën e sigurimeve shoqërore.

Marrëveshja do iu sigurojë qytetarëve shqiptarë një sërë përfitimesh, si:

- pensionin e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare për të punësuarit, të vetëpunësuarit, si dhe për punëdhënësit;
- përfitimet në para në rast sëmundje, për barrëlindjen dhe për rastet e aksidenteve në punë.
- gjithashtu do të sigurojë bashkimin e periudhave kontributive, duke bërë që qytetarët të mos humbasin vitet e tyre të punës.

Raundi i dytë i negociatave për Marrëveshjen Administrative do të zhvillohet në Tiranë.

MEKI BËHET GATI PËR SEZONIN VEROR 2024

Këtë sezon veror, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është gati për një udhëtim plot dinamika drejt promovimit dhe ruajtjes së trashëgimisë sonë kulturore. Bazuar në trendin aktual të rritjes së vizitorëve nga Janari deri në Mars 2024, 28 institucionet tona të trashëgimisë kulturore pritet të vizitohen gjatë këtij viti nga afërsisht nga 1,700,000 vizitorë vendas dhe të huaj, një rritje e ndjeshme prej 64% vizitorë më shumë krahasuar me vitin e kaluar.

